

REDUKTIMI I TRANSAKSIONEVE NË PARA TË GATSHME NË KOSOVË

TERMAT E REFERENCËS

I - Objektivat e Projektit

1. Për të përgatitur kodin e mirësjelljes dhe mundësisht rregullat për veprimet dhe masat që duhen ndërmarrë nga bankat, komuniteti i biznesit dhe individët privat për reduktimin e vëllimit të transaksioneve në para të gatshme.
2. Për të arritur konsensus ndërmjet bankave, me qëllim të nënshkrimit dhe zbatimit të kodit të mirësjelljes dhe rregulloreve.

II - Zhvillimi i Projektit

Grupi i menaxhimit të projektit do të veprojë në bazë të mandatit të dhënë nga Këshilli Kombëtar i Pagesave për marrjen e iniciativave në reduktimin e mëtejshëm të vëllimit të transaksioneve me para të gatshme në kuadër të sistemit bankar.

Grupi për menaxhimin e projektit do të punojë në arritjen e konsensusit në mesin e bankave të Kosovës për protokolet dhe mundësisht rregulloren që do të çojnë në uljen e vëllimit të transaksioneve në para të agtshme. Qëllimi kryesor i këtyre protokoleve / marrëveshjes do të jetë:-

- a. reduktimin e transaksioneve në para të gatshme, duke dekurajuar përdorimin e parave të gatshme për të gjitha palët e interesuara- bankat, bizneset dhe individët;
- b. rritjen e transaksioneve që nuk bëhen në para të gatshme duke krijuar procese dhe infrastruktura që nxisin të gjitha palët e interesuara për të përdorur alternativa tjera ndaj parasë së gatshme.

III- Fazët e propozuara të projektit

1. Marrëveshje për Termat e Referencës dhe krijimi i Ekipit të Projektit
2. Kuptimi i gjendjes aktuale dhe kornizës rregullatore.
3. Krahasimi me praktikën më të mirë dhe analiza e boshllëkut.
4. Krijimi dhe dakordimi rreth qëllimit dhe objektivave të projektit.
5. Ndryshimet e propozuara dhe veprimi i rekomanduar rregullator ose protokolar.
6. Analizat e Kostos / Benifitit
7. Dokumenti i politikave për konsultime dhe marrëveshje.
8. Implementimi i propozimeve të rena dakord

IV – Krijimi i fushëveprimit të Projektit

Fushëveprimi dhe shtrirja e projektit do të përgatiten në bazë të rezultateve të veprimeve të poshtëshënuara:

1. Studimi dhe analiza e situatës aktuale, duke përfshirë vëllimin e transkacioneve në para të gatshme dhe atyre që nuk bëhen në para të gatshme, llojet e transaksioneve, çmimin, proceset, rregulloret, etj.
2. Një analizë e kostove të bankave të gjeneruara nga proceset e trajtimit, depozitimit, sigurimit dhe transportit të parave të gatshme.
3. Një analizë e kostove dhe beneficioneve potenciale nga institucionet e mëdha që gjenerojnë dhe pranojnë pagesa - për shembull KEK-u, kompanitë e ujit dhe industria e telekomit.
4. Hulumtimi i përvojës ndërkombëtare dhe praktikave më të mira.
5. Një kuptim i qartë i analizave të boshllëkut - ku ndodhemi dhe ku duam të arrijmë - dhe marrëveshja me Këshillin Kombëtar i Pagesave mbi objektivat dhe indikatorët kyç të performances.